REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PER SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 08 Nr. Br. 23419
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 20/10 2020
KAMENICË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Komisioni për ndarjen e Subvencioneve për nënat që lindin fëmijë.

Datë: 16.10.2020

Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës Sh.02, Nr. 22546, të datës 08.10.2020, për ndarjen e Subvencioneve si dhe Vendimit Sh.02, Nr. 22639, të datës 09.10.2020, për Formimin e Komisionit për Ndarjen e Subvencioneve, Komisioni për Ndarje të Subvencioneve, pas takimit të mbajtur më 16.10.2020, paraqet këtë:

# N J O F T I M

Aplikim për Subvencione për Fëmijët e Porsalindur

**Kriteret për aplikim:**

Për të aplikuar për Subvencione në vlerë prej 200€ (dyqind euro), prindërit aplikues duhet ti plotësojnë këto kritere:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
2. Të dy prindërit të jenë banorë të Komunës së Kamenicës dhe
3. Të kenë lindur fëmijën nga data 08.10.2020 dhe tutje, brenda territorit të Republikës së Kosovës.

**Dokumentet të cilat janë të domosdoshme për të aplikuar janë:**

1. Letërnjoftimi i prindërve;
2. Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
3. Certifikatë e vendbanimit të prindërve;
4. Vërtetim i Këshillit Lokal (*që dëshmon se jeni nga ai vendbanim*);
5. Certifikatë e Kurorës (për prindërit e kurorëzuar), ndërsa për ata të pakurorëzuar Deklaratën e bashkësisë familjare;
6. Për prindin vetëushqyes – Deklaratën e bashkësisë familjare;
7. Konfirmimi i llogarisë bankare i njërit prind.

Komisioni për ndarjen e Subvencioneve është në përbërje si në vijim:

1. Liridona BAJRA, Kryesuese ____________
2. Nafije AJVAZAJ, Anëtare____________
3. Besa MORINA, Anëtare ____________

*Për sqarim: Pagesa bëhet për çdo fëmijë individualisht, afati i aplikimit zgjatë 45 (dyzet e pesë) ditë, pas lindjes së fëmijës.*